 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Udhëzues për tranzicionin për ISO</b>  <b>22003-1:2022</b></p>	<p><b>Kodi: DA-IN-030</b></p> <hr/> <p><b>Rishikim nr 0</b>  <b>Dt: 05.10.2023</b></p> <hr/> <p><b>Faqe 1 nga 5</b></p>
--	--	---


**Udhëzues për kalimin nga standardi ISO/TS 22003:2013 në standardin ISO 22003-1:2022**

**Zbatues:** Stafi i DPA-së, vlerësuesit teknik dhe organet certifikues të sistemeve të menaxhimit të sigurisë ushqimore, grupi teknik i punës për organet certifikuese.

**Përgjegjës për zbatim:** Drejtori i Drejtorisë së Organeve Certifikuese dhe Inspektuese

**Kontrolli:** Menaxheri i Cilësisë  
Ardita MELE

**Miratoi:** Drejtori i Përgjithshëm  
Pranvera FAGU

 <p> <b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b> </p>	<p> <b>Udhëzues për tranzicionin për ISO</b>  <b>22003-1:2022</b> </p>	<b>Kodi: DA-IN-030</b>
		<b>Rishikim nr 0</b> <b>Dt: 05.10.2023</b>
		<b>Faqe 2 nga 5</b>

## 1 Qëllimi

Ky dokument përshkruan udhëzime për kalimin nga standardi ISO/TS 22003:2013 në standardin ISO 22003-1:2022. Ky dokument është i vlefshëm për DPA dhe vlerësuesit e saj si dhe për organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të sigurisë ushqimore të akredituar nga DPA, organet certifikuese të sistemeve të menaxhimit të sigurisë ushqimore që kanë aplikuar për akreditim apo që kanë për qëllim të aplikojnë për akreditim. Ky dokument është i vlefshëm deri në datën 30 Qershor 2025.

## 2 Fusha e zbatimit

Ky udhëzues zbatohet nga vlerësuesit dhe stafi i DPA, nga nënkontraktuesit e saj për vlerësimin e organeve certifikuese që kryejnë certifikim të sistemeve të menaxhimit të sigurisë ushqimore në përputhje me këtë standard, grupi teknik i punës për organet certifikuese.

## 3 Përgjegjësitë

Ky udhëzues është pjesë e sistemit të menaxhimit të DPA dhe si i tillë është nën përgjegjësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit rishikimi i vazhdueshëm në varësi të ndryshimeve të duhura dhe përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin e menaxhimit të DPA. Drejtori i Drejtorisë së Organeve Certifikuese dhe Inspektuese ka detyrë të kontrollojë zbatimin e këtij udhëzuesi.

## 4 Referimet

Kjo procedurë i referohet:

- Standardi S SH ISO 17011:2017,
- IAF MD 27:2023, versioni 1, Kërkesat e tranzicionit të ISO 22003-1:2022.

## 5 Përkufizime


Në këtë udhëzues është përdorur terminologjia e standardit SSH ISO/IEC 17011:2017

IAF Forum Ndërkombëtar i Akreditimit  
DPA Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

## 6. PËRMBAJTJA

### 6.1. Të përgjithshme

Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit (IAF) ka vendosur një periudhë tranzitore 3 vjecare (36 muaj) për kalimin nga

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Udhëzues për tranzicionin për ISO</b>  <b>22003-1:2022</b></p>	<p><b>Kodi: DA-IN-030</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 0</b>  <b>Dt: 05.10.2023</b></p>
		<p><b>Faqe 3 nga 5</b></p>

standardi ISO/TS 22003:2013 në standardin ISO 22003-1:2022. Referuar dokumentit IAF MD 27:2023, versioni 1, periudha e tranzicionit për standardin ISO 22003-1:2022 do të vazhdojë deri më datë 30 Qershor 2025. DPA do të jetë gati për të kryer vlerësime sipas ISO 22003-1:2022 jo me vonë se data 31 Dhjetor 2023. DPA do të fillojë të kryejë vlerësime fillestare sipas ISO 22003-1:2022 jo me vonë se 30 Qershor 2024. DPA duhet ta përfundojë vlerësimin e procesit të tranzicionit të organeve certifikuese të sistemeve të menaxhimit nga ISO/TS 22003:2013 në ISO 22003-1:2022 jo me vonë se data 31 Dhjetor 2024. Preferohet që tranzicioni të përfundojë deri në 30 Qershor 2024 me qëllim që organet certifikuese të fillojnë certifikimin fillestar jo më vonë se kjo datë. Nëse një organ certifikues i akredituar nuk përfundon në mënyrë të suksesshme vlerësimin e tranzicionit deri në datën 31 Dhjetor 2024, vlefshmëria e akreditimit sipas ISO 22003:2013 përfundon në datën 30 Qershor 2025.

Organi certifikues i akredituar do të fillojë ofrimin e certifikimit fillestar të kompanive sipas standardit ISO 22003-1:2022 jo më vonë se data 30 Qershor 2024, por vetëm pasi të jetë akredituar për këtë skemë. Organi certifikues i akredituar duhet të përdorë standardin ISO 22003-1:2022 për të gjithë klientët jo më vonë se data 31 Dhjetor 2024. OVK duhet ta përfundojë procesin e tranzicionit nga ISO/TS 22003:2013 në ISO 22003-1:2022 të klientëve të saj të certifikuar deri më datë 30 Qershor 2025.

## **6.2 VEPRIMET E ORGANIZMIT AKREDITUES.**


DPA do të trajtojë vlerësuesit, kryevlerësuesit, specialistët e dosjeve, vendimmarrësit, anëtarët e grupit teknik përkatës në lidhje me kërkesat e ndryshuara dhe të reja të ISO 22003-1:2022 si dhe me procesin e tranzicionit.

Për rastin e organeve certifikuese që aplikojnë për akreditim sipas ISO 22003-1:2022, DPA do të kryej vlerësimin fillestar të tyre duke filluar nga 31 Dhjetor 2023. Asnjë aplikim për akreditim fillestar/zgjerim sipas ISO/TS 22003:2013 nuk pranohet pas dates 1 Dhjetor 2023. Për të gjitha aplikimet sipas ISO/TS 22003:2013 te cilat kane ardhur përpara datës 1 Dhjetor 2023 por vizita vlerësuese nuk është kryer deri në datën 31 Dhjetor 2023, vlerësimi do të vazhdojë sipas ISO 22003-1:2022.

Për organet certifikuese të akredituara më ISO/TS 22003:2013, DPA do të shqyrtojë ndryshimet në ISO 22003-1:2022, analizat e mangësive të cdo organi certifikues të akredituar sipas skemës së certifikimit ISO 22003:2013, planet e tranzicionit/zbatimit, dokumentacionin e ndryshuar ku të reflektohen ndryshimet sipas versionit të ri të ISO 22003, autorizimet e personelit për ISO 22003-1:2022, evidenca të zbatimit të versionit të ri të ISO 22003-1:2022 dhe cdo informacion tjetër që DPA mund tju kërkojë organeve certifikuese. Organet certifikuese të akredituara nga DPA do të dërgojnë dokumentacionin e mësipërm jo më vonë se data 31 Janar 2024.

Nëse rezultati i vlerësimit të dokumentacionit është pozitiv (organi certifikues ka demonstruar plotësimin e kërkesave të versionit të ri të ISO 22003-1:2022), DPA nuk organizon vizitë në zyrat e organit certifikues. Shqyrtimi i dokumentacionit nga ana e DPA do të llogaritet minimum një ditë pune dhe do të paguhet nga organi certifikues i akredituar.

Nëse rezultati i vlerësimit të dokumentacionit nuk është pozitiv (organi certifikues nuk demonstron plotësimin e kërkesave të versionit të ri të ISO 22003-1:2022), DPA organizon vizitë në zyrat e organit certifikues. Kohezgjatja e vizitës bazohet në analizën e riskut. Vizita në organin certifikues për vlerësimin e tranzicionit të ISO 22003-

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Udhëzues për tranzicionin për ISO</b>  <b>22003-1:2022</b></p>	<p><b>Kodi: DA-IN-030</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 0</b>  <b>Dt: 05.10.2023</b></p>
		<p><b>Faqe 4 nga 5</b></p>

1:2022 do të jetë gjatë vizitës mbikëqyrëse ose në një vizitë shtesë. Vizitat shtesë, nëse janë të nevojshme do të zhvillohen në periudhën Shkurt-Maj 2024. Vlerësimi me dëshmi nuk është i nevojshëm.

DPA do të përditësojë informacionin e akreditimit të organeve certifikuese të akredituara (p.sh. certifikatën e akreditimit), nëse kompetenca e tyre për ISO 22003-1:2022 është demonstruar.

Vlerësimi në zyrën e OVK-së duhet të fokusohet në verifikimin e zbatimit të marrëveshjes së tranzicionit pavarësisht se kjo marrëveshje nuk është zbatuar plotësisht. Vlerësimi në zyrë duhet të përfshijë të paktën:

- Zbatimi i proceseve dhe procedurave të rishikuara të organit certifikues.
- Kompetenca e personelit përkatës është demonstruar para se të përfshihen në aktivitetet e certifikimit kundrejt ISO 22003-1:2022.
- Ecuria e tranzicionit për klientët e certifikuar kundrejt standardit ISO 22003-1:2022.

Vlerësimet me dëshmi të planifikuara për tu zhvilluar pas vendimit për kalimin e tranzicionit do të bazohen në standardin ISO 22003-1:2022 duke vënë fokusin në vlerësimin e kompetencës së auditorëve për të kryer auditimet kundrejt ISO 22003-1:2022.

### **6.3 VEPRIMTARITË E ORGANEVE CERTIFIKUESE**

Organi certifikues duhet të krijojë planin e tranzicionit për ISO 22003-1:2022 duke marrë parasysh kërkesat e këtij standardi dhe rregullat e përcaktuara për tranzicionin nga DPA. Plani i tranzicionit do të përcaktojë se çfarë do të bëjë organi certifikues dhe çfarë do të bëjë klienti.

Rekomandohet që Organet e Certifikimit të:


a) Planifikojnë dhe të përgatiten për të aplikuar tek DPA për tranzicionin dhe të bëhen gati për zbatimin e kërkesave të reja sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzues.

b) Zhvillojnë një plan tranzicioni duke përfshirë çështjet e mëposhtme:

- Identifikimin e ndryshimeve ndërmjet versionit të ri dhe atij të vjetër të standardit dhe analizën e mangësive. Proceset e konsideruara për ndryshime mund të përfshijnë shitjet/kuotimin, procesin e auditimit, menaxhimin e kompetencave dhe komunikimin me klientet ekzistues të certifikuar.

-Analizimin e impaktit të ndryshimeve në aktivitetet/proceset përkatëse dhe identifikimin e veprimeve të kërkuara për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e versionit të ri të standardit (psh. Sistemi i menaxhimit/dokumentat, IT, etj);

- Sigurimin që personeli përkatës është kompetent sipas versionit të rishikuar dhe procesin e tranzicionit;

 <p><b>Tel: +355 4 22 69097</b>  <b>+355 4 22 69325</b>  <b>Fax:</b>  <b>E-Mail: info@dpa.gov.al</b></p>	<p><b>Udhëzues për tranzicionin për ISO</b>  <b>22003-1:2022</b></p>	<p><b>Kodi: DA-IN-030</b></p>
		<p><b>Rishikim nr 0</b>  <b>Dt: 05.10.2023</b></p>
		<p><b>Faqe 5 nga 5</b></p>

- Grupi i auditimit, në tërësi, duhet të ketë njohuri për të gjitha kontrollet e sigurisë ushqimore të përfshira në ISO 22003-1:2022 dhe zbatimin e tyre;

- Programi i auditimit të tranzicionit;

- Përcaktimin e komunikimit në kohë me klientin për programin e tranzicionit, të tilla si afati kohor, përcaktimin e auditimit të tranzicionit dhe pasojat nëse klienti nuk arrin të kalojë përpara përfundimit të periudhës së tranzicionit;

c) Fillimin e veprimeve të nevojshme sa më shpejt që të jetë e mundur.

Organet certifikuese mund të kryejë auditimin e tranzicionit gjatë auditimeve të mbikqyrjes, të ricertifikimit ose nëpërmjet një auditimi të veçantë. Auditimi i tranzicionit nuk duhet të mbështetet vetëm në rishikimin e dokumentave, veçanërisht për rishikimin e kontrolleve të sigurisë ushqimore.

Auditimi i tranzicionit përfshin, por nuk kufizohet në:

- Analiza e boshllëqeve të ISO 22003-1:2022.
- Nëse është e aplikueshme, përditësimi i planit të trajtimit të rrezikut.
- Zbatimi dhe efektiviteti i kontrolleve të reja ose të ndryshuara të zgjedhura tek klientët

Organi certifikues mund të kryejë edhe një auditim në distancë mjafton që të plotësohen objektivat e auditimit të tranzicionit.

Organet e certifikimit mund të përcaktojnë afatin kohor për dorëzimin e aplikimit për tranzicionin nga klientët e certifikuar në programin e auditimit të tranzicionit. Organi certifikues duhet të marrë vendimin e tranzicionit bazuar në rezultatin e auditimit të tranzicionit.

Të gjitha certifikatat e lëshuara kundrejt ISO/TS 22003:2013 duhet të skadojnë ose tërhiqen në fund të periudhës së tranzicionit.

#### **6.4. Certifikimet e organeve certifikuese.**

Certifikimet e reja dhe ricertifikimet:

Organet certifikuese duhet të përdorin versionin e ISO 22003-1:2022 për certifikim fillestar apo ricertifikim vetëm pas akreditimit të tyre sipas ISO 22003-1:2022.